KOMRA

Përmbledhje e politikave

Si mundet Bashkimi Evropian për t'i kontribuuar pajtimit të vendeve post-jugosllave

KOMRA

SI MUNDET BASHKIMI EVROPIAN PËR T'I KONTRIBUUAR PAJTIMIT TË VENDEVE POST-JUGOSLLAVE

Përmbledhje e politikave

mars 2018

SI MUNDET BASHKIMI EVROPIAN PËR T'I KONTRIBUUAR PAJTIMIT TË VENDEVE POST-JUGOSLLAVE

Përmbledhje e politikave

BOTUES:
Koalicioni për KOMRA-m
mars 2018

REDAKTORË:
Ana Marjanoviq Rudan

AUTORË:
Amer Alija
Jelena Gjokiq Joviq
Anka Hajdari Kurteshi
Natasha Kandiq
Marina Kljajiq
Ana Marjanoviq Rudan
Sven Milekiq
Vesna Tersheliq

DIZAJNI:
Todor Cvetkoviq

PAJTIMI NË KONTEKSTIN E PERSPEKTIVËS SË PËRTËRITUR EVROPIANE TË VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Në teori, koncepti i pajtimit nënkupton një qark kompleks të proceseve, me të cilat, pas shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, ndërtohen dhe përtëriten marrëdhëniet në nivel ndërpersonal, shoqëror-politik ose institucional[1]. Është gjerësisht i përhapur botëkuptimi[2] se pajtimi është parakusht i paqes së qëndrueshme, proces përmes të cilit zgjidhen çështjet e trashëgimisë së rëndë.

Koncepti i paqes i cili përdoret në këtë tekst ka të bëjë me nivelin shoqëror-politik dhe institucional – me ndërtimin dhe përtëritjen e marrëdhënieve midis vendeve post-jugosllave, grupeve dhe bashkësive politike e etnike si dhe me vendosjen e besimit në institucionet e reja.

Në një lidhje të ngushtë me konceptin e pajtimit është drejtësia tranzicionale. Instrumentet themelore të saj – konstatimi i përgjegjësisë penale për krimet e kryera në të kaluarën, zbulimi dhe paraqitja e fakteve mbi viktimat, reparacionet dhe reformat e institucioneve, e nxisin pajtimin në masën në të cilën qeveritë në tranzicion e pranojnë dënimin e përgjegjësve për krimet e kryera, pranimin zyrtar të viktimave, demokratizimin dhe kthimin e besimit në institucionet si rrugë e vendosjes së sundimit të ligjit dhe parandalimit të konflikteve të reja.

Në lidhje me gjendjen në pikëpamje të drejtësisë tranzicionale dhe të pajtimit në vendet post-jugosllave, komisari për të drejtat e njeriut i Këshillit të Evropës, Nils Muiznieks, në muajin dhjetor të vitit 2017, e ka shprehur brengën e tij të madhe, duke e tërhequr vërejtjen lidhur me frenimin dhe „mbizotërimin e polarizimeve etnike dhe të tjerave në rajon". Posaçërisht është vënë theksi në mohimin e gjenocidit, glorifikimin e krimeve të luftës dhe të kryerësve të tyre, revizionizmin historik, diskursin e ndezur dhe segregacionin sipas bazave etnike në domenin e arsimit[3].

Në deklaratat e tij të kohëve të fundit, Serge Brammertz, ish prokurori i Gjykatës Ndërkombëtar Penale për ish Jugosllavinë (GJNPJ), kurse prokuror i tashëm i Mekanizmit për Gjykata Ndërkombëtare Penale (MGJNP), e ka tërheq vërejtjen lidhur me „mungesën e vullnetit të sinqertë në rajon që të pranohen faktet mbi krimet e kryera", si dhe lidhur

1 Sipas: Seils, P. (2017), *The Place of Reconciliation in Transitional Justice – conceptions and misconceptions*, ICTJ Briefing, ICTJ. (*Vendi i pajtimit në Drejtësinë Tranzicionale – konceptet dhe keqkuptimi tyre*, Brifing i GJPNJ, GJPNJ

2 Sipas: Fischer, M. (2011), *Transitional Justice and Reconciliation: Theory and Practice*, Advancing Conflict Transformation: The Berghof Handbook II, eds., Opladen/Framington Hills. (*Drejtësia Tranzicionale dhe Pajtimi: Teoria dhe Praktika*, Përparimi i transformimit të konflikteve: Libri i Berghofit II, bot. Opladen/Framington Hills.

3 Human Rights Comment, CoE, https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/reconciliation-stalled-in-the-western-balkans.

me „glorifikimin tmerrues të kriminelëve të luftës dhe mohimin e krimeve të luftës”[4], por edhe në „mohimin e gjenocidit dhetë spastrimit etnik” dhe „mohimin e fajit individual të zyrtarëve të lartë politik dhe ushtarak”[5].

Organizatat joqeveritare, të cilat merren me të drejtat e njeriut dhe drejtësinë tranzicionale kanë vlerësuar se fundi i mandatit të GJNPJ (dhjetor, 2017) në vendet post-jugosllave, posaçërisht në Serbi dhe Kroaci, është pritur si një çlirim nga obligimet e ndjekjes penale të krimeve të luftës.

Së këndejmi, *Strategjia e KE-së për Ballkanin Perëndimor për një perspektivë të besueshme të zgjerimit*[6] (shkurt, 2018) paraqet një përgjigje të fuqishme të BE-së në problemet e rajonit të ish Jugosllavisë të krijuara, pjesërisht, edhe për shkak të gabimeve të BE-së. Dokumenti, si një nga tri fushat në të cilat janë të domosdoshme „reformat gjithëpërfshirëse dhe bindëse”, krahas sundimit të ligjit dhe kompetivitetit, e njeh edhe pajtimin si dhe bashkëpunimin rajonal. Në mesin e gjashtë nismave përmes të cilave do t’i kontribuojnë kësaj strategjie, Komisioni Evropian parasheh edhe nismat të cilat do ta mbështesin pajtimin, midis të tjerash, edhe përmes përkrahjes së mekanizmit të drejtësisë tranzicionale.

Strategjia e ka në vizion pajtimin në nivelin politik dhe institucional, gjë që e ka qartësuar David Hudson, ekspert i lartë i Drejtorisë së Komisionit Evropian për Fqinjësi dhe Zgjerim[7], duke e vënë theksin në atë se pajtimi është „pronë rajonale”, se askush jashtë rajonit nuk mund ta përcaktoj qasjen për pajtimin. Ai e ka theksuar përgjegjësinë e liderëve politik si dhe faktin se çfarëdo përparimi në procesin e pajtimit përbënë një „indeks të pjekurisë demokratike dhe politike”[8]. Megjithëkëtë, si dokument i përgjithshëm, Strategjia nuk i përkufizon indikatorët e përparimit në këtë fushë dhe kërkon saktësim të rreptë përmes aksioneve të dokumentit.

---

4 P.sh. BIRN report (Raport i BIRN-it), Qershor 22, 2017, Balkan Insight, http://www.balkaninsight.com/rs/article/glorifying-war-criminals-impedes-justice-says-brammertz-06-22-2017.

5 Fjala e Serge Bramercit, e prokurorit ndërkombëtar të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë dhe Mekanizmi për Gjykatat Penale Ndërkombëtare, Këshilli i Sigurimit, Nju Jork, 7 qershor i vitit 2017.

6 COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE EUROPEAN PARLIAMENT, THE COUNCIL, THE EUROPEAN ECONOMIC AND SOCIAL COMMITTEE AND THE COMMITTEE OF THE REGIONS, A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans. (KOMUNIKATË NGA KOMISIONI I PARLAMENTIT EVROPIAN, KËSHILLI, KOMITETI EVROPIAN EKONOMIK DHE SOCIAL DHE KOMITETI I RAJONEVE) Një perspektivë e besueshme e zgjerimit për një angazhim të përforcuar të BE-së në Ballkanin Perëndimor.

7 Në panel në kuadër të Forumit të 11-të për drejtësinë tranzicionale në vendet post-jugosllave, në datën 29 janar të vitit 2018 në Sarajevë; për më shumë shih në: Balkan Insight report, Jan 29, 2018, http://www.balkaninsight.com/en/article/recom-announces-state-forming-agreement-soon-01-29-2018.

8 Hudson, e njëjta.

PARAKUSHTET PËR PAJTIM

Parakushtet për përparim në lidhje me pajtimin realizohen përmes drejtësisë penale dhe zbulimit e paraqitjes së fakteve (të së vërtetës) mbi të kaluarën, me fokusim të veçantë në viktimat. Për këtë arsye, në këtë tekst vëmendje e veçantë i kushtohet ndjekjes penale të krimeve të luftës, posaçërisht në dritën e ndërprerjes së punës së GJNPJ, si dhe gjendjes së gjërave në lidhje me nismën e koalicionit rajonal të shoqërisë civile për themelimin e komisionit rajonal zyrtar (ndërqeveritar) për konstatimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut *në territorin e ish RSFJ-së* prej datës 1 janar të vitit 1991 deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001 (KOMRA).

GJYKIMI PËR KRIMET E LUFTËS

Duke qenë se GJNPJ e ka përfunduar punën në muajin dhjetor të vitit 2017 dhe Paneli Special i Kosovës do të merret me ndjen penale të krimeve të luftës të cilat i kanë kryer pjesëtarët e UÇK-së, ndjekjen penale e krimeve të luftës të cilat i kanë kryer shtetasit e Serbisë, Kroacisë dhe B dhe H është ekskluzivisht në kompetenca të organeve të gjyqësorit vendor. Në lidhje me këtë, në raportin përfundimtar të cilin si kryeprokuror i GJNPJ ia ka paraqitur Këshillit të Sigurimit në lidhje me përfundimin e punës në muajin dhjetor të vitit 2017[9], Serge Brammertz e tërheq vërejtjen se „mbesin shumë sfida në konstatimin e përgjegjësisë para gjykatave nacionale të vendeve të ish Jugosllavisë për krime të luftës, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid", si edhe se „trendet negative mbizotërojnë mbi ato pozitive". Brammertz më tutje i cek sfidat kyçe në vende të caktuara – krahas vlerësimit të përgjithshëm të përparimit në Bosnjë e Hercegovinë, posaçërisht kur është fjala për situatat komplekse, dhe e thekson se edhe më tutje „mbetet një numër i madh i rasteve të krimeve të luftës", si edhe se është fjala për një „politizim të fuqishëm të drejtësisë" në lidhje me to; në Kroaci, siç ceket, „vazhdon një përzierje e vrazhdë politike në procesin e drejtësisë, deri sa organet qeveritare nuk e sigurojnë bashkëpunimin efikas me gjyqësorin në lidhje me numrin e madh të të dyshuarve dhe të të akuzuarve të cilët sot jetojnë lirisht", derisa përparimin në gjykimet për krimet e luftës në Serbi e ka vlerësuar si „posaçërisht të pakënaqshëm", duke theksuar se „mosndëshkimi për shumë krime të vërtetuara është bërë normë".

9 Final Report of Serge Brammertz, Prosecutor of the International Tribunal for the Former Yugoslavia, provided to the Security Council under paragraph 6 of SC Resolution 1534 (2004), str. 82. (Raport Final i Serge Brammertz, Prokuror i Gjykatës Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë, siguruar nga Këshilli i Sigurimit sipas paragrafit 6 të Rezolutës së KS 1534 (2004) f. 82)

Gjatë vitit 2017 ndjekja penale e krimeve në vendet e ish Jugosllavisë në mënyrë shtesë është margjinalizuar – numri i vogël i aktakuzave, pamjaftueshëm të zhvilluara në kontekstin e fakteve të konstatuara para GJNPJ, numri i vogël i të akuzuarve, kryesisht i kryerësve të drejtpërdrejt, me një numër të vogël të viktimave të përfshira, që është përcjellë me heqjen dorë të dëshmitarëve që drejtpërsëdrejti të dëshmojnë (për shkak të moshës së shtyrë dhe gjendjes së dobët shëndetësore, por më së shumti për shkak të mosbesimit në gjykatën e shtetit, të cilën e konsiderojnë përgjegjëse për çështjen e tyre), me heqjen e aktgjykimeve të shkallës së parë, me të cilat është i përfshirë një numër i madh i viktimave, me zvarritjet e shpeshta të shqyrtimeve kryesore, me anonimizimin gjithnjë e më të fuqishëm të aktgjykimeve dhe aktakuzave gjyqësore, si dhe me qasjen e kufizuar ndaj informatave, me fotografitë dhe provat e tjera në posedim të gjykatave, e në lidhje me krimet e kryera të luftës. Për këtë dëshmojnë të dhënat mbi gjykimet në vitin 2017:

- GJYKATA e B dhe H i ka sjellë 15 aktgjykime jo të plotfuqishme, në proceset kundër 28 të akuzuarve për krimet e kryera të luftës, me më shumë se 60 viktima. Ajo ua ka shqiptuar gjashtëmbëdhjetë të akuzuarve aktgjykimet liruese, në të cilat Prokuroria është përgjigjur me deponimin e ankesave. Panelet gjyqësore kanë sjellë gjithsejtë pesë aktgjykime të plotfuqishme, në lëndët kudër shtatë të akuzuarve për krime të luftës me më shumë se 45 viktima. Një i akuzuar, i cili e ka pranuar veprën penale, është gjykuar me një vit burgosje[10]. Gjatë vitit 2017 janë ngritur 14 aktakuza kundër 32 personave për krime në të cilat kanë qenë së paku 59 viktima. Disa gjykime kanë filluar në vitin 2017, midis të tjerave për krimet e luftës kundër të burgosurve të luftës në Orashje/ Orašje.
- Në Kroaci janë ngritur tetë aktakuza kundër 25 të akuzuarve, me të cilat janë përfshirë më shumë se 120 viktima. Janë sjellë shtatë aktgjykime jo të plotfuqishme kundër 12 të akuzuarve, me të cilat janë përfshirë më shumë se 60 viktima dhe 11 aktgjykime të plotfuqishme kundër 25 të akuzuarve, me të cilat janë përfshirë më shumë se 150 viktima. Në procedurën e shkallës së parë për krim në fshatrat te Una të Kostajnicës kroate (Una kod Hrvatske Kostajnice), gjykimi ka filluar në muajin shkurt të vitit 2010 kurse aktgjykimi lirues i plotfuqishëm është sjellë në datën 9. 11. 2017. Kanë paraprirë katër gjykime, tri të përsëritura, para dy gjykatave dhe tri aktgjykime dënuese. Gjykimi i parë ka filluar para Gjykatës së Qarkut në Sisak. Gjykimi për krime të luftës ndaj serbëve në Fushën e Pakracit (Pakračka poljana) dhe në Panairin e Zagrebit (Velesajam u Zagrebu) ka përfunduar 26 vite pas kryerjes së krimit. Gjykata Supreme në datën 2. 2. 2017

10 Miroslav Periq i dënuar me 1 vit (pranim i veprës penale).

e ka modifikuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe të akuzuarit Tomislav Merçepit ia ka ngritur sanksionin penal nga pesë e gjysmë në shtatë e gjysmë vite burgosje. Në vitin 2017 janë caktuar rreth 100 seanca.

- Në Kosovë[11] deri në vitin 2016 prokurorët dhe gjyqtarët ndërkombëtarë kanë qenë kompetent për ndjekjen penale të krimeve të luftës. Gjatë vitit 2017 janë ngritur katër aktakuza: tri kundër një të akuzuari (Zoran Vukotiqit, serb) për krim të luftës me të cilën janë përfshirë 110 viktima shqiptare. Një aktakuzë e ka ngritur prokurori i EULEX-it, kurse dy i kanë ngritur së bashku me prokurorin e EULEX-it edhe prokurori vendor. Prokurori i EULEX-it e ka ngritur aktakuzën kundër Skender Bislimit (pjesëtar i RAE[12]) për krim të luftës kundër një personi, për keqtrajtim fizik të një civili i cili është rrëmbyer kurse më vonë është vrarë. Nuk ka pasur asnjë aktgjykim të plotfuqishëm të shkallës së parë. Në vitin 2017 gjithsejtë kanë qenë 59 ditë gjyqësore.
- Në Serbi, në bazë të lëndëve të cilat i ka dorëzuar Departamenti i Posaçëm për Krime të Luftës i Prokurorisë së B dhe H, prokurori për krime të luftës i ka ngritur tri aktakuza kundër katër personave (një numër i panjohur i viktimave). Paneli gjyqësor i Gjykatës së Lartë në Beograd me aktgjykim të shkallës së parë i ka liruar dy të akuzuar për vrasje të pesë personave. Para Gjykatës së Apelit janë zhvilluar dy gjykime: i pari është gjykimi për njëzet e katër të akuzuarit për krime të luftës ndaj të burgosurve dhe të plagosurve ("Ovçara"/„Ovčara"), i cili ka filluar në vitin 2004, kurse ka përfunduar me aktgjykimin e dytë të plotfuqishëm të datës 24. 11. 2017 – njëmbëdhjetë prej tyre janë dënuar, nëntë janë liruar, dy të akuzuar kanë vdekur, derisa dy prej tyre e kanë pasur statusin e dëshmitarëve bashkëpunues; gjykimi tjetër është gjykimi për tetë të akuzuarit për krime të luftës ndaj romëve (lënda "Skoçiq"/„Skočić", 32 viktima) i cili ka filluar në vitin 2010. Para Gjykatës së Lartë në Beograd është në zhvillim e sipër rigjykimi i katërmbëdhjetë të akuzuarve për krime të luftës ndaj civilëve kroat (lënda „Lovas", 50 viktima), i cili ka filluar në vitin 2008, dhe gjykimi i trembëdhjetë të akuzuarve për krim të luftës ndaj civilëve shqiptarë ("Qyshku"/„Ćuška", 48 viktima), i cili ka filluar në vitin 2010. Pos aktgjykimit të plotfuqishëm në lëndën "Ovçara"/„Ovčara", gjatë vitit 2017 janë sjellë edhe aktgjykime të plotfuqishme, të dyja liruese – në lëndën "Gradishka"/ „Gradiška" (një i akuzuar, një viktimë) dhe lënda „Bosanski Petrovac" (dy të akuzuar dhe një viktimë). Në vitin 2017 gjithsejtë kanë qenë 70 ditë të gjykimit.

11 Prokurorët ndërkombëtarë në periudhën e viteve 2000–2017 gjithsejtë i kanë ngritur 48 aktakuza për krimet e luftës kundër 120 personave: 61 shqiptarëve, 48 serbëve, 2 malaziasve dhe një pjesëtari të RAE. Panelet ndërkombëtare me përbërje të përzier i kanë shqiptuar 48 aktgjykime të shkallës së parë.

12 Pjesëtar i bashkësisë së Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve.

Pos kësaj, ndjekja penale e krimeve të luftës politikisht është margjinalizuar edhe në mënyra të tjera – Prokuroria e B dhe H ende nuk ka kryeprokuror, gjë që ka qenë rasti edhe me Serbinë, që vetëm në muajin maj të vitit 2017 është bërë me prokuror të krimeve të luftës. Prokuroria e Republikës së Serbisë ende nuk ka strategji për hetimin dhe ndjekjen e krimeve të luftës (miratimi i saj është paralajmëruar deri në muajin qershor të vitit 2018), deri sa, nga ana tjetër, në B dhe H është formuar Grupi Punues për përpunimin e ndryshimeve dhe të plotësimeve të Strategjisë së B dhe H për punën në lëndët e krimeve të luftës. Prokuroria Shtetërore e Republikës së Kroacisë (PSHRK) e ka strategjinë e ndjekjes penale të krimeve të luftës, por ajo në praktikë nuk njihet.

Gjykimet para Gjykatës së B dhe H zhvillohen nën kritikën e fortë të institucioneve dhe shoqatave të luftës të Republika Srpska, si edhe bashkësisë kroate, që konsiderojnë se me Strategjinë ekzistuese të Prokurorisë së B dhe H viktimat serbe dhe kroate janë të margjinalizuara. Në Kosovë, qeveria dhe parlamenti, por edhe i tërë opinioni shqiptar, janë të qëndrimit se themelimi i Dhomave Speciale të Kosovës që do të gjykojnë pjesëtarët e një bashkësie etnike është një zgjidhje e padrejtë dhe shenjë e mospranimit të viktimave shqiptare. Në Serbi dhe Kroaci, mbylljen e GJNPJ, në muajin dhjetor të vitit 2018, Qeveritë, parlamenti dhe një pjesë e madhe e opinionit publiku e kanë pranuar me një lehtësim të madh, si pajtim të SHBA-ve dhe BE-së se ndjekja e krimeve të luftës ka përfunduar.

MOSMARRËVESHJET DYPALËSHE

Ndjekja penale e krimeve të luftës në Serbi bëhet sipas *Ligjit mbi organizimin e kompetencave të organeve shtetërore në procedurat për krimet e luftës i vitit* 2003 (sipas të cilit Republika e Serbisë është kompetente për t'i gjykuar të gjithë ata që kanë bërë krime të luftës në territorin e ish RSFJ-së (parimi i kompetencës universale), me zbatimin e të cilit janë burgosur dy shtetas të Kroacisë në vitin 2011, e pastaj janë akuzuar dhe gjykuar për krime të luftës ndaj serbëve, gjë që ka shkaktuar reagime të stuhishme politike në Kroaci. Si përgjigje ndaj burgosjes së shtetasve kroat (luftëtarëve), Kuvendi i Republikës së Kroacisë në datën 22. 10. 2011 e ka miratuar *Ligjin për shfuqizimin e akteve të caktuara ligjore të organeve gjyqësore të ish-APJ-së, ish RSFJ-së dhe Serbisë*, i cili sipas vlerësimeve të ekspertëve ligjor ua ka shkurtuar luftëtarëve kroat të drejtën në mbrojte përmes ndihmës juridike të institucioneve të Republikës së Kroacisë dhe ua ka imponuar ndjenjën e pasigurisë kur udhëtojnë jashtë shtetit të tyre.

Me qëllim që të tejkalohen problemet e krijuara, ish kryetarët e Kroacisë dhe të Serbisë, Ivo Josipoviq dhe Boris Tadiq, në muajin shkurt të vitit 2012 e kanë filluar nismën për nënshkrimin e marrëveshjes bilaterale, sipas së cilës çështja e krimeve të luftës do të zgjidhej sipas vendbanimit të të akuzuarit. Në pajtim me këtë parim, marrëveshja

bilaterale do ta tejkalonte ligjin serb mbi kompetencën universale, por edhe ligjin kroat mbi shfuqizimin e akteve juridike të prodhuara në Serbi. Presidenca e B dhe H, e cila po ashtu ka qenë e ftuar për të nënshkruar këtë marrëveshje bilaterale, nuk e ka pranuar zgjidhjen e propozuar, duke u përcaktuar për zbatimin e kompetencës territoriale, që të gjykohet në shtetin në të cilin është kryer krimi i luftës. Ministritë e Drejtësisë dhe prokuroritë e Kroacisë dhe të Serbisë kanë qenë në rrugë të nënshkrimit të marrëveshjes bilaterale, por zgjedhjet presidenciale në Serbi e pastaj edhe zgjedhjet presidenciale në Kroaci kanë sjellë një kthesë në marrëdhëniet e Serbisë e të Kroacisë, kurse rezultatet e deriatëhershme janë përmbysur. Megjithëkëtë, një hap në përmirësimin e bashkëpunimit bilateral në ndjekjen penale të krimeve të luftës përbënë gatishmëria e shprehur kohët e fundit (shkurt, 2018) e kryetarit të Serbisë Aleksandër Vuçiqit dhe e kryetares së Republikës së Kroacisë Kolinda Grabar Kitareviq që institucionet e Kroacisë dhe të Serbisë t'i vazhdojnë punët e ndërprera rreth nënshkrimit të marrëveshjes bilaterale mbi ndjekjen penale të krimeve të luftës sipas vendbanimit të të akuzuarve.

ORGANI JASHTËGJYQËSOR PËR ZBULIMIN DHE PARAQITJEN E SË VËRTETËS (KOMRA)

Komisioni rajonal ndërqeveritar për konstatimin e fakteve mbi viktimat në lidhje me luftën dhe rrethanat e vdekjes së tyre, me vulën e saj, duhet të pamundësojë manipulimet dhe interpretimet politike, të cilat e rrezikojnë lidhjen dhe bashkëpunimin. Kjo do ta ngushtonte hapësirën për gënjeshtra, mohim, prodhim të narrativave nacionaliste mbi luftën dhe do t'i kontribuonte humanizmit të të tjerëve, stabilitetit dhe sigurisë së rajonit si dhe qëndrueshmërisë së bashkëpunimit ekonomik, e në të njëjtën kohë do të mundësonte edhe reformat e programit të arsimimit në pjesët që kanë të bëjnë me historinë e kohëve jo të largëta.

Organizatat joqeveritare nga hapësira e ish Jugosllavisë në vitin 2008 e kanë themeluar Koalicionin për KOMRA-n, i cili sot tubon mbi 2100 organizata dhe individë dhe i cili angazhohet për themelimin e Komisionit Rajonal për konstatimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut në hapësirën e ish RSFJ-së (KOMRA). Nismën për themelimin e Komisionit me nënshkrimet e tyre e kanë përkrahur mbi 580.000 qytetarë nga i tërë rajoni, kurse pas një procesi të gjerë konsultativ, përfshirës, katërvjeçar (gjatë të cilit janë organizuar 128 debate në të cilat kanë marrë pjesë 6700 përfaqësues të shoqërisë civile), janë formuluar objektivat, detyrat, kompetencat, kohëzgjatja dhe procedurat e punës për komisionin e ardhshëm ndërshtetëror. Duke u nisur nga kjo bazë, versionin final të Projekt Statutit të KOMRA-s e kanë harmonizuar në vitin 2014 të dërguarit special të kryetarëve të Kroacisë, Serbisë,

Malit të Zi, Kosovës dhe Maqedonisë si dhe anëtari boshnjak dhe ai kroat i Presidencës së Bosnjës e Hercegovinës.

Në ndërkohë, në B dhe H janë zgjedhur dy anëtarë të Presidencës (2014), me të cilët Koalicioni për KOMRA-n ende nuk ia ka dalë për ta organizuar një takim, derisa anëtari boshnjak i Presidencës ka vazhduar për ta mbështetur themelimin e KOMRA-s ; në Kroaci është zgjedhur kryetari i ri (2015), i cili konsideron se përkrahja për themelimin e KOMRA-s është jashtë kompetencave të kryetarit. Në këtë situatë, në të cilën disa politikanë të zgjedhur kohët e fundit kanë pushuar së përkrahuri nismat civile të cilat kanë gëzuar përkrahjen e pararendësve të tyre, Koalicioni për KOMRA-n ka krijuar një strategji të re, e cila niset nga Procesi i Berlinit si platformë përkatëse për marrëveshjen e liderëve post-jugosllav mbi inicimin e projektit ndërshtetëror për pajtim. Hapi i parë është nënshkrimi i Marrëveshjes mbi themelimin e KOMRA-s, në samitin në kuadër të Procesit të Berlinit në Londër në muajin korrik të vitit 2018, me të cilin kryeministrat e vendeve post-jugosllave përkrahja e të cilave është e pandryshueshme (e pavarur nga zgjedhjet), do të manifestonin gatishmërinë e shteteve të tyre për ta nisur procedurën për themelimin e KOMRA-s në pajtim me nenin 48 të Projekt Statutit. Një hap tjetër po aq i rëndësishëm është angazhimi i sërishëm i Kroacisë në procesin KOMRA, në të cilin deri në fillim të vitit 2015 ka pasur rol udhëheqës.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Për përparim në pajtimin e vendeve post-jugosllave ka nevojë për si më poshtë:

1. Fuqizim të gjyqësorit vendor dhe bashkëpunimin e tyre reciprok në ndjekjen penale të krimeve të luftës:

- Përkrahje për atë që Mekanizmi për Gjykata Penale Ndërkombëtare (MGJPN) të bëhet motor i bashkëpunimit rajonal në ndjekjen penale të krimeve të luftës – të ndihmojnë në krijimin e një strategjie rajonale prokuroriale, për të siguruar një qasje më të lehtë ndaj provave dhe fakteve para GJNPJ, për ofrim të përkrahjes profesionale në hetimet dhe në përgatitjen e aktakuzave kundër individëve të cilët kanë marrë pjesë në planifikimin e krimeve masive, kurse sot janë në pozita të cilat i mbrojnë nga përgjegjësia penale.
- Zgjidhje të mosmarrëveshjeve bilaterale midis Serbisë dhe Kroacisë me nënshkrimin e marrëveshjes bilaterale mbi ndjekjen penale të krimeve të luftës, me të cilën gjykimet do të bëheshin sipas vendbanimit të të akuzuarve, gjë që në praktikë do të shmangte pasojat e mundshme të dëmshme të zbatimit të parimit të kompetencës universale, të përmbajtur në ligjin e Republikës së Serbisë dhe Ligjit Kroat mbi shfuqizimin e akteve juridike të prodhuar në Serbi.

- Heqja dorë e Presidencës së B dhe H nga parimi i kompetencës territoriale dhe pranimi i standardit që secili shtet t'i gjykojë shtetasit e vet, sepse kjo qasje më së shumti i kontribuon hulumtimit kritik brenda shoqërisë dhe ballafaqimit me përgjegjësinë vetanake ndaj të tjerëve.

2. Nënshkrimin e marrëveshjes politike, me të cilën vendet post-jugosllave do të obligohen që në një afat të arsyeshëm të krijojnë kushte për themelimin e KOMRA-s:

- Nënshkrimi i Marrëveshjes në kuadër të Procesit të Berlinit në Samitin e Londrës në muajin korrik të vitit 2018. Marrëveshja duhet të përmbajë mundësinë e inkuadrimit të mëvonshëm si dhe thirrjen për vendet e tera të mbetura në atë kuptim.
- Rritja e vizibilitetit të objektivave dhe të detyrave të Komisionit të ardhshëm, posaçërisht i rëndësisë së regjistrimit të viktimave të luftës në kontekstin e humanizimit të viktimave të tjera dhe të pranimit publik të të gjitha 130.000 viktimave.

3. Plani i veprimit *Strategjia për Ballkanin Perëndimor i Komisionit Evropian për një perspektivë të besueshme të zgjerimit* duhet të parasheh masat me të cilat shprehimisht:

- Do të mbështetet themelimi dhe puna e Komisionit rajonal për konstatimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut në territorin e ish RSFJ-së në periudhën prej datës 1 janar të vitit 1991 deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001 (KOMRA), si dhe që themelimin dhe fillimin e punës së këtij komisioni deri në fund të vitit 2019 ta përkufizojë si indikator të përparimit në procesin e pajtimit;
- Do të përkrah bashkëpunimin e prokurorive vendore me MGJPN në krijimin dhe implementimin e një strategjie rajonale prokuroriale si dhe që të përkufizojë hartimin e strategjisë deri në mesin e vitit 2019 si indikator i përparimit në vendosjen e sundimit të ligjit dhe kontributit në procesin e pajtimit.

4. Parlamenti Evropian duhet të ofrojë përkrahje të fuqishme për pajtimin në rajon përmes një rezolute, me të cilën do të mbështetej themelimi dhe puna e komisionit ndërqeveritar rajonal – KOMRA-s.

- Komisioni evropian dhe Parlamenti Evropian duhet të organizojnë një konferencë të donatorëve dhe themelimin e *Fondit post-jugosllav për pajtimin* – i cili do të financonte projektet rajonale të drejtuara nga ndërtimi i paqes dhe zgjidhja e përbashkët e problemeve dhe i cili do të përfshinte të gjitha vendet post-jugosllave.

www.perkomra.org
www.recom.link